



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHYESVE TË OSBE/ODIHR, PËR VËZHGIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës .06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

OBJEKT: Miratimi i përkthyesve të paraqitur nga OSBE/ODIHR, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

ODIHR është një prej organizatave të krijuara në kuadrin e OSBE, duke u kthyer që me themelimin e saj në organizmin kryesor të monitorimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

ODIHR monitoron përmes vëzhguesve, zgjedhjet në vendet anëtarë të OSBE-së duke patur parasysh kriteret e lirive themeltare, universalizmit, pluralizmit politik, besimit,



Nr. 850 i Vendimit

Data 22.06.2019 Ora 12 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e përkthyesve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019

transparencës dhe përgjegjshmërisë. Në këtë kuptim ODIHR mbështetet në një metodologji sistematike dhe afatgjatë vëzhgimi me qëllim përmirësimin e proceseve zgjedhore përmes raporteve post-zgjedhore dhe asistencës teknike.

OSBE/ODIHR ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ-së për akreditimin e 106 (njëqind e gjashtë) përkthyesve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e OSBE/ODIHR për akreditimin e 106 (njëqind e gjashtë) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

